



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Analizë Teksti e Gjuhës B (3)

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor, Gjuhë Angleze

Kodi i etikës: Kodi i Etikes i UT-së (Nenet 4, 6,7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektiva te përgjithshme lëndore: Të përmirësojë dhe konsolidojë kompetencat gjuhësore në të katër aftësitë bazë të gjuhës (lexim, dëgjim, të folur dhe shkrim) në një nivel të avancuar akademik dhe funksional. Të përgatisë studentët për të kuptuar dhe përdorur gjuhën angleze në kontekste të ndryshme akademike, sociale dhe kulturore, përfshirë stilin formal dhe joformal. Të zhvillojë mendimin kritik dhe ndërgjegjësimin gjuhësor, përmes analizës së kuptimit të teksteve, përdorimit të strategjive të leximit dhe interpretimit të gjuhës në kontekst. Të pasurojë dhe zgjerojë fjalorin aktiv të studentëve, duke i ndihmuar të kuptojnë dhe përdorin fjalë të reja në mënyrë të natyrshme gjatë komunikimit dhe aktiviteteve mësimore.

Objektivat specifikë lëndorë:

1. Të aftësojë studentët për të lexuar dhe kuptuar tekste akademike, shkencore dhe informale nga burime ndërkombëtare (MB, SHBA etj.).
2. Të mësojë studentëve strategjitë e avancuara të leximit, si: leximi midis rreshtave, parashikimi, skanimi, përzgjedhja e informacionit dhe interpretimi i shumëkuptimeve.
3. Të zhvillojë aftësitë e dëgjimit me materiale autentike, duke u fokusuar në kuptimin për qëllime specifike dhe përdorim praktik në situata reale.
4. Të përmirësojë aftësitë e të shkruarit në një nivel të lartë, me fokus në stilin, regjistrin dhe përshtatjen ndaj lexuesit.

Rezultatet e të nxënit :

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

1. Të lexojnë, kuptojnë dhe përdorin tekste të zhanreve të ndryshëm nga fusha të ndryshme të botës akademike;
2. Të kuptojnë detaje, kuptime të ndryshme fjalësh, shprehje dhe fjali, kuptimin e nënkuptuar, organizimin dhe strukturën e teksteve;
3. Të komunikojnë lirshëm dhe në mënyrë efikase duke përdorur fjalor akademik për fusha të ndryshme;
4. Të krijojnë tekste të shkruara për tema të ndryshme, të cilat kanë ndikim në zhvillimin një